



REPubLIKA E KOSOVËS

REPubLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. /2026

Dt.10.02.2026

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 shkronja d të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 21 pika d të Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr.011/04-29365 të datës 28.12.2022, në nenin 3.8 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me dt.10.02.2026, pas diskutimeve lidhur me pikën e 6-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2026, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për

Planin e Punës së Kuvendit

1. Miratohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2026.
2. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2026 do të mbahen të Enjten e dytë të çdo muaji, gjithashtu mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2026 do të mbahen të Enjten e fundit të çdo muaji.
3. Kuvendi i Komunës së Gjakovës në kuadër të aktiviteteve vjetore do të organizojë vizita bashkëpunimi në institucione dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare.
4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2026.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.
6. **Vendimi iu dërgohet:**
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
 - Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.
 - Drejtorive Komunale.
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit.



Kryesues i Kuvendit të Komunës

z. Shefqet Shehu

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin - 2026

Pikat e rendit të ditës

JANAR	<ol style="list-style-type: none">1. Informatë e Kryetarit të Komunës mbi Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2026.2. Shqyrtimi i Raportit Vjetor për Monitorimin e Planit të Integritetit në Komunën e Gjakovës për vitin 2025.
	<ol style="list-style-type: none">1. Informatë mbi Planin e Punës së Zyrës së Prokurimit për vitin 2026.2. Informatë për Planin e Punës së Injesisë së Auditorit të Brendshëm për vitin 2026.3. Shqyrtimi i progresit të adresimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit të ekzekutivi komunal .
SHKURT	<ol style="list-style-type: none">1. Shqyrtimi i Raportit Final Financiar të Komunës së Gjakovës për Vitin 2025.2. Bartja (rialokimi) i buxhetit të pashepuar nga viti i kaluar në vitin aktual.3. Monitorimi i zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal 2022-2030 dhe Hartës Zonale Komunale 2024-2032.4. Raporti i gjendjes së Mjedisit në Komunën e Gjakovës.5. Informatë për përgatitjet ndaj emergjencave në Komunën e Gjakovës.6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.
MARS	<ol style="list-style-type: none">1. Shqyrtimi i informatës financiare të Komunës së Gjakovës për periudhën Janar – Mars 2026.2. Informatë për ndriçimin publik në Komunën e Gjakovës.3. Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror.4. Raporti vjetor i 3 Ndermarrjeve Publike Lokale për vitin 2025.5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.
PRILL	<ol style="list-style-type: none">1. Informatë e përgjithshme nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenije Sociale.2. Informatë mbi Qarkorën e parë të Ministrisë së Financave.3. Informatë mbi përgatitjet për mirëmbajtjen verore të rrugëve në Komunën e Gjakovës.4. Informatë e punës nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.
MAJ	

QERSHOR	<ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029. 2. Informatë për monitorimin dhe realizimin e kontratave për dhënie e pronës së paluajtshme në shfrytëzim. 3. Raporti i Kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve Investese në Komunën e Gjakovës për periudhën Janar-Qershor 2026. 4. Shqyrtimi i raportit rreth aktiviteve të KKSb-së. 5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.
KORRIK	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Gjakovës për vitin 2025, plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunitës. 2. Shqyrtimi i informatës së II-të Financiare të Komunës së Gjakovës për periudhën Janar – Qershor 2026. 3. Informatë mbi përfundimin e viti shkollor 2025-2026 në Komunën e Gjakovës. 4. Informatë nga Drejtorja për Inspektive . 5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.
GUSHT	PUSHIM
SHTATOR	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi dhe miratimi i normës tatimore për tatimin në pronë e paluajtshme për vitin 2027. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës së Gjakovës për vitin 2027. 3. Shqyrtimi i Raportit të Performancës në Komunën e Gjakovës. 4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.
TETOR	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i informatës së III financiare të Komunës së Gjakovës për periudhën Janar – Shtator 2026. 2. Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Gjakovës. 3. Informatë mbi implementimin e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Gjakovës. 4. Informatë mbi përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2026-2027 në Komunën e Gjakovës . 5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.

NENTOR	<ol style="list-style-type: none"> 1. Informatë e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Gjakovës për vitin 2026. 2. Informatë e përgjithshme për zhvillimin e Bujqësisë në Komunën e Gjakovës. 3. Raporti i Punës së Komitetit për Komunitete, Komisioneve dhe Komiteteve të tjera, të themeluara nga Kuvendi. 4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.
DHJETOR	<ol style="list-style-type: none"> 1. Raporti i Kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare dhe Zbatimi i Planeve Investuese në Komunën e Gjakovës për vitin 2026. 2. Shqyrtimi i raportit rreth aktiviteve të KKSBS-së për vitin 2026. 3. Miratimi i Planit të Punës së KKSBS-së 2027. 4. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2027. 5. Informatë për monitorimin dhe realizimin e kontratave për dhënie e pronës së paluajtshme në shfrytëzim. 6. Informatë mbi realizimin e Planit vjetor të Prokurimit për vitin 2026. Informatë mbi kontratat kornizë të Komunës së Gjakovës.